

JUP KASTRATI

NAIMI PËR GJUHËN SHQIPE

1. — Gjuha e Naimit është bërë objekt studimi, për të parën herë, nga albanologu i mirënjohur Norbert Jokl.¹ Studimi i tij, që u botua me rastin e 25-vjetorit të vdekjes së poetit, miret me kontributin e vyer që solli Naim Frashëri në pasurimin e gjuhës shqipe. «Historia e gjuhëve të kulturuara — thekson albanologu ynë — na mëson prej shumë shembujsh që gjinden periudha, ku pasurimi i fjalorit është i nevojshëm. Në histori të çdo populli ka disa ndërrime udhësh që, mbas një gjumi shumë të gjatë, zgjohet ai popull përsëri për të gëzuar një jetë të re mendore. Kështu edhe veprimtaria e Naim Frashërit bie në një periudhë të tillë të historisë shqiptare. Po deshëm të gjykojmë punën e tij, do të bëjmë mirë, në qoftë se e masim atë me shembuj të popujve të tjerë, edhe ta krahasojmë me kërkime që kanë dalë nëpër letërsitë e tjera.» Siç shihet, që në fillim, veprimtarinë e poetit të shquar e vendos mirë në kuadrin historik, në kushte të caktuara historike, në periudhën e Rilindjes sonë kombëtare, kur ai krijoi dhe veproi. Përpara se të hyjë e të flasë mbi punën e madhe që bëri Naimi për gjuhën shqipe, Jokl-i sjell shembuj konkretë të këtij lloji që gjinden, aty-këtu, ndër gjuhët e huaja. Këtë gjë, dijetari ynë, e bëri për të treguar se, ndoshta, poeti i ka pasë parasysh, si modele. Këtu thekson rolin e Leibnitz-it në gjuhën gjermane, në mbarim të shekullit XVII dhe në fillim të shekullit XVIII. Pastaj ai përmend luftën që u ndez në Hungari për të përtri gjuhën, në dhjetë vjetet e fundit të shekullit XVIII dhe në fillim të shekullit XIX. Një shumicë e madhe fjalësh të reja u derdh përmbi gjuhën — jo pa luftë të rreptë të përtrisëve të gjuhës (F. Kazinczy e ndjekësit e tij) me kundërshtarët. Pothuajse, po më atë kohë, shohim përpjekje të tilla në letërsinë çeke, ku filologu J. Jungmann-i e pasuroi çekishten simbas mënyrës së Leibnitz-it. Edhe në serbisht V.S. Karadžić-i ka ecë nëpër atë rrugë. «Nuk është detyra e këtij përshkrimi të shkurtë — thekson Jokl-i — të përmbledhim të gjitha neologjizmat që gjejmë te Naim Frashëri dhe t'i shkoqisim të gjitha. Duhet të kufizohemi vetëm tek më të përmendurat. Do të provoj ta klasifikoj lëndën dhe ta qes në dritë të gjuhësisë.» Studimi i Jokl-it ka tri pjesë. Në pjesën e parë, ai ka shqyrtuar fjalët e sajuara nga Naimi me anë të prapashtesave: *-i*, *-ësi*, *-irë* (geg. *-inë*), *-tar*, *-ar*, *-arak*, *-tuar*, *-tor*, *-ore*, *-ës*, *-je*, *-im*, *-shim*, *-m*, *-nik*. Tek çdo formim ka bërë shënime të gjera gjuhësore, nga ana dialektore dhe leksikore, sidhe sqarime historike. Në pjesën e dytë të studimit, Jokl-i ka vëzhguar kompozitat, duke ndjekur Brugmann-in përsa i takon klasi-

1) Norbert Jokl, *Naim be Frashëri e pasurimi i gjuhës shqipe*, në botimin përkujtimor «Naim Frashërit! Vjershëtorit dh'edukatorit kombëtar», Graz (Austria), 1925, fq. 84-97.

fikimit të tyre. Këto formime të Naimit i ka ndarë në pesë grupe. Në pjesën e tretë, autori merret me ringjalljen e fjalëve të vjetra dhe pak a shumë të harruara edhe me përdorimin e krahinarizmave të rralla në veprat e poetit. Këtu ka zbuluar disa fjalë të moçme, të lëna në harresë, të cilat i ka marrë Naimi nga shkrimtarët e letërsisë së vjetër shqipe, duke i ringjallur. Ka shënuar edhe disa fjalë të përhapura ndër të folmet tona, duke i tërheqë në visarin e fondit të tij dhe duke i futë në përdorim të përgjithshëm. Studiuesi ynë ka vënë në dukje edhe krijimet e fjalëve të reja, duke i përkthyer ato nga forma e brendshme, d.m.th. kalket gjuhësore. Ku ka qenë e nevojshme, dijetari ynë ka bërë edhe krahasime me shkrimtarë të tjerë shqiptarë, që kanë punuar për zhvillimin dhe pasurimin e gjuhës sonë, si b.fj. me Matrëngën, Budin, Bardhin, Bogdanin, Kamardën, Kristoforidhin, Sami Frashërin, Konicën etj. Të dhëna për krahasim ka sjellë edhe nga De Rada, Hahn, Meyer, Jungg, Weigand, «Bashkimi», Pekmezi, etj. Nga citimet që ka bërë, rezultojnë të mos ketë vjelë lëndë nga të gjitha veprat e poetit, por vetëm nga: «Mësimet», «Parajsa dhe fjala fluturake», «E këndimit çunavet këndonjëtoreja», «Fletore e bektashinjet». Gjatë analizës së vet, Jokli nxjerr disa konkluzione që janë për t'u vënë re. Simbas tij, Naimi, në disa raste, është mbështetur te Kristoforidhi. Në pjesën dërmuese, formimet e poetit tonë ndjekin modelet e gjuhës popullore. «Me rëndësi për në — shton Jokli — është të krahasojmë neologjizmat e Naim Frashërit me gjuhën e pullit dhe t'i mërrimë gjykimit: a i përgjigjet shkrimtari ynë programit të Leibnizit: mbarasim me të vjetrit, të cilin e thërrasim analogji». Duke përfunduar punimin e vet, ky dijetar shkruan pikërisht këto: «Ndonëse të gjitha fjalët, që formoi Naimi, nuk hynë në përdorim të përgjithshëm, prapëseprap metoda e tij për të sajuar fjalë të reja do të mbesë gjithmonë si model».

Aleksandër Xhuvani i ka kushtuar një studim të veçantë gjuhës së Naimit. Në punimin «Naimi si poet e si prozator», botuar më 1947², autori ka shqyrtuar një varg çështjesh, si ë-ja e pazëshme, emrat e mbiemrat, rasat e emrave dhe të mbiemrave, përemrat, fjalë të reja e të përngjitura, theksimi, ndajfoljet, lidhëzat, parafjalët, sinonimet, lokucionet, etj. Vërejtjet e gjuhëtarit tonë përqendrohen në pikëpamje fonetike, morfologjike, semasiologjike, leksikologjike. Lënda është vjelë nga këto vepra të Naimit: «Dituritë». «E këndimit çunavet këndonjëtoreja» (I, II), «Mësimet», «Istori e Shqipërisë», «Istori e përgjithëshme», «Gjithësija». A. Xhuvani thekson, që në fillim, se Naimi ka qenë një nga poetët e parë e të shquar të Rilindjes sonë, që, me poezitë e tij, ka përhapë këndimin e shkrimit e gjuhës shqipe, të ndaluar atëhere prej qeverisë turke; ka zgjuar vetëdijën kombëtare dhe ka bërë gati rrugën e vetëqeverimit dhe të pavarësisë shqiptare. Fara që hodhi Naimi me anë të veprave të tij, mbiu me të shpejtë në Shqipëri, thujse nëpër gjithë krahinat e saj. Veprat e tij u shpërndanë atëhere, jo vetëm në jugë të Shqipërisë, ku zu të këndohet e të shkruhet shqipja prej të rinjvet dhe prej pleqvet, por edhe në Shqipëri të mesme e në atë të veriut. Muza e poetit kumboi anë e kënd atdheut tonë. Ai nuk ka qenë vetëm vjershëtor, por edhe prozator. Ky apostull i idesë kombëtare i caktoi vetes misionin e lartë, që, me anë të veprave të tij, në poezi e në prozë, të përhapë gjuhën

2) Aleksandër Xhuvani, *Naimi si poet e si prozator*, «Literatura jonë» I, 3-4, 9-30, Tiranë, maj-qershor 1947.

shqipe dhe, me anë të kësaj, si mjet kulture dhe edukate kombëtare, të zgjojë kombin e ta bëjë gati për të flakë zgjedhën e robërisë për t'u bërë zot më vete, në tokën e vet. Xhuvani ka meritën të ketë interpretuar një seri fjalësh nga ana kuptimore, simbas përdorimit të poetit. Duke përfunduar studimin, ai vë në dukje me të drejtë se gjuha e Naimit në prozë është një gjuhë e thjeshtë popullore, pa stërhollime, po e pastër, e gëruar dhe krejt shqipe. Naimi nuk kujdeset që të na japë një gjuhë letrare me stil të lartë e të zbukuruar; me veprat e tij, si në prozë ashtu edhe në poezi, ai kujdeset që të veprojë mbi mendjen e mbi zemrën e popullit, për ta zhvilluar atë e për ta bërë të zotin që të qeveriset vetë me fuqitë e veta. Dhe këtij qëllimi dëshëron që ti'a mërrijë populli me anë të gjuhës së vet; prandaj duket kujdesi i tij i madh për të shkruar një gjuhë popullore, të kuptueshme, që t'i përshtatet fuqisë mendore të popullit të ulët, një gjuhë të kulluar e të pastër shqipe. «Kur këndon njeriu — thotë Xhuvani — prozën e Naimit, si «Dituritë», «Gjithësinë», etj. e kupton se gjindet përpara një njeriu të popullit, që flet gjuhën e rrjedhëshme të nënës së vet, një gjuhë pa halë e pa kokë, pa barbarizma e fjalë të huaja. Në këtë gjuhë të Naimit nuk kuptohet aspak përkthimi nga një gjuhë e huaj».

Kostaq Cipo ka dhënë mendime të vlefshme në lidhje me gjuhën e poetit. Ai thotë: «Naimi shkroi në dialekt të kulluar dhe bëri mirë, se dialekti është gurra e gjallë e popullit, se aty janë fshehur thesaret e gjuhës».³ Në vitin 1953, redaktoi dhe pajisi me shënime gjuhësore veprën e Naimit: «Histori e Skënderbeut».⁴ Aty ka vëzhgime të holla fonetike në fushën e vokalizmit dhe të konsonantizmit. Në mënyrë të veçantë janë për t'u shënuar fenomenet fonetike, si asimilimi, disimilimi, metateza, aglutinacioni, atrakcioni, shtesat, heqjet, etj. Ka vërejtje me rëndësi në lëmin e morfologjisë dhe të sintaksës, sidomos të sintaksës poetike. Komenti gjuhësor është i pasur me sqarime dhe interpretime në fushën e leksikologjisë. Mund të themi se, kryesisht, mbi bazën e veprave të Naimit, Cipua hartoi Fonetikën, Morfologjinë⁵ dhe Sintaksën e gjuhës shqipe⁶, të cilat edhe i botoi.

Kontribute me vlerë për njohjen e gjuhës së Naim Frashërit, ka sjellë Shaban Demiraj në një seri punimesh. Në studimin «Gjuha e Sami Frashërit»⁷, autori ka pasë parasysh edhe shkrimet e veprat e Naimit, të botuara para vitit 1898, të cilat i ka analizuar, duke i krahasuar me ato të Samiut dhe të Kristoforidhit. «Studimi — thekson autori — për vetë natyrën e tij, paraqitet i ndërlikuar, sepse leksiku i përdorur nga Samiu nuk mund të trajtohet i shkëputur nga ai që kanë përdorur shkrimtarët e tjerë të kohës së tij dhe përpara tij». Në këtë studim janë trajtuar në kapituj të veçantë: 1) Fjalët derivate me parashtesa e prapashtesa; 2) Mbiemrat e substantivuar; 3) Kompozitat; 4) Një fjalorth me fjalë e terma të patrajtuara në kapitujt e mëparshëm. Për çdo fjalë janë vënë edhe shënimet përkatëse rreth etimologjisë, kuptimit,

3) K. Cipo, *Lulet e Verësë* (Mendime), «Illyria», I, 37, 3, Tiranë, 4 janar 1936.

4) Naim H. Frashëri, *Histori e Skënderbeut*, Redaktuar e pajisur me shënime nga Prof. Kostaq Cipo. Tiranë, Shtëpia botonjësë «Naim Frashëri». F. 344 + VI.

5) K. Cipo, *Gramatika shqipe*. Tiranë, 1949. F. 192. Botim i Institutit të Shkencave

6) K. Cipo, *Sintaksa*. Tiranë, 1952. F. 126. Botim i Institutit të Shkencave.

7) Shaban Demiraj, *Gjuha e Sami Frashërit*, «Buletin për shkencat shoqërore», Tiranë, 3 (1955) 191-236.

prejardhjes apo përdorimit të saj. Aty, ku ka qenë rasti, janë cituar edhe autorë të tjerë. Është ndjekur gjithënjë rendi alfabetik si në radhitjen e parashtesave dhe të prapashtesave ashtu edhe në renditjen e fjalëve. Studimi në fjalë karakterizohet nga saktësia shkencore dhe nga qartësia e metodika e paraqitjes. Studiuesi ynë vëren, që në fillim, se «...shkrimtarët tanë patriotë të lëvizjes kombëtare, Kristoforidhi, Samiu, Naimi, etj. i vunë vehtes si detyrë, nga njera anë, ta pasuronin leksikun e shqipes me fjalë të reja të krijuara nga vetë brumi i saj, duke u mbështetur në më të shumtën e rasteve në modelet e gjuhëve të tjera dhe, nga ana tjetër, ta pastronin atë nga barbarizmat e kota dhe të shumta, që e kishin përmbytur. Kjo punë fisnike, që dëshmon si dashurinë e tyre të madhe për gjuhën amëtare ashtu edhe seriozitetin e përpjekjeve të tyre si shkrimtarë e si gjuhëtarë, dha shpejt frutet e saj. Në më pak se gjysëm shekulli gjuha jonë u pasurua dhe u zhvillua në mënyrë që njeriu mund të shprehte me anën e saj gjithëfarë mendimesh e ndjenjash, siç na dëshmojnë veprat e pleiadës së shkrimtarëve, të mëdhenj e të vegjël, që shkruan e punuan në gjysmën e fundit të shekullit të kaluar dhe në fillim të shekullit tonë». Duke përfunduar monografinë e vet, Shaban Demiraj nxjerr një konkluzion me rëndësi, që çel shtigje për studime të mëtejshme në të ardhmen: «Një gjë tjetër, që bie në sy në leksikun e shkrimeve të Samiut, është se shumë nga fjalët e reja, sidomos të terminologjisë shkencore, i gjejmë si te ai, ashtu dhe te Naimi. Sikurse është shënuar gjatë këtij studimi, disa nga këto terma i gjejmë të përdorura te Samiu, kurse disa të tjera te Naimi. Sido që të jetë, është e natyrshme që të dy vëllezërit të kenë bashkëpunuar dhe të jenë këshilluar midis tyre në këtë pikë. Por megjithatë ky bashkëpunim nuk duhet të ketë qenë i plotë, sepse nganjëherë tek ata gjejmë fjalë a trajta fjalësh të ndryshme, që tregojnë se secili syresh ndiqte nganjëherë një rrugë më vehte. P.sh. ndërsa Samiu përdor *ujëqyrë* për astronomi, Naimi përdor *qiellëshkronjë*; ndërsa Samiu përdor njëherë *dhekërkronjë* dhe një herë *dhetregonjë* për gjeologji, Naimi përdor vetëm *dhetregonjë*. Samiu përdor *tejshkronjës* për telegraf, kurse Naimi *tejshkronjë*. Veç këtyre, ndërsa Samiu përdor herë *i qytetëruar* herë *i qytetuar*, Naimi shkruan gjithënjë *i qytetëruar*; ndërsa Samiu përdor gjithënjë *pastaj*, Naimi shkruan thuasjse gjithënjë *pasdaj*, etj.». Të dhëna me rëndësi për disa veçori të gjuhës së veprave të Naimi Frashërit gjejmë edhe në studimin tjetër të Shaban Demirajt: «Disa shënime rreth lëvrimit të gjuhës shqipe gjatë shekullit të XIX»⁸ Aty flitet mbi fjalorin, mbi ortografinë, mbi përpjekjet për të afruar të dy dialektet e shqipes në të shkruar; bëhen disa vërejtje rreth formave dhe konstrakteve duke nxjerrë konkluzione dhe përgjithësime. Disa karakteristika të gjuhës së Naimit epen nëpërmjet metodës krahasuese me shkrimtarë të tjerë të kohës së tij. Ky punim me vlerë u përfshi edhe në pjesën e dytë të dispensës së hartuar prej tij: «Historia e gjuhës së shkruar shqipe»⁹. Në këtë monografi janë hedhë mendime të ndryshme që shërbejnë si teza për studime më të thella mbi një çështje gjuhësore apo mbi një tjetër. Shënime për gjuhën e Naimit ka bërë Shaban Demiraj edhe në redaktimin e dy veprave të

8) Shaban Demiraj, *Disa shënime rreth lëvrimit të gjuhës shqipe gjatë shekullit të XIX*, «Buletin i USHT, Seria shkencat shoqërore», 4(1958) 120-137; 1(1959) 49-79.

9) Shaban Demiraj, *Historia e gjuhës së shkruar shqipe*, USHT, Fakulteti historio-filologji, Katedra e gjuhës shqipe. Tiranë, maj 1962, fq. 52-99 (dispensë).

poetit: «Bagëti e bujqësija»¹⁰ dhe «Lulet' e verësë»¹¹, të cilat duhen pasur parasysh nga një studiues i gjuhës së poetit, mbasi të japin dorë dhe të sugjerojnë idé.

Konsiderata me rëndësi për gjuhën e Naimit kanë dhënë edhe: Dhimtër S. Shuteriqi¹², Behar Shtylla¹³, Shefqet Musaraj¹⁴, Nonda Bulka¹⁵, Andrea Varfi¹⁶, Zija Xholi¹⁷, e ndonjë tjetër. Gjatë këtij punimi, në vendet përkatëse, do të citohen simbas problemeve që do të trajtohen.

2. — Dihet se Naimi ka qenë një poliglott i vërtetë. Ai ka njohur gjuhët klasike (greqishten dhe latinishten), gjuhët e lindjes (persishten, arabishten, turqishten), gjuhët e gjalla (greqishten e re, frëngjishten), simbas një burimi të tërthortë, ka të ngjarë të ketë njohur edhe italishten e gjermanishten. Ai ka qenë i përgatitur, jo vetëm nga ana praktike, po edhe teorike. Me sa duket, ka pasur dijeni për disa parime të përgjithshme të shkencës së gjuhësisë. Kjo përgatitje e ka ndihmuar për t'u marrë edhe me çështje të gjuhës. Në të vërtetë, vepra e tij e parë e botuar është «Gramatika e persishtes simbas metodës së re»¹⁸, botuar në Stamboll më 1871. Të dhënat për këtë vepër gjuhësore të poetit po i nxjerrim nga një studim i Hasan Kaleshit¹⁹. Në këtë vepër Naimi nënshkruhet vetëm Mehmed Naim, nëpunës në Drejtorinë e shtypit (Kalem-i Matbuat apo Matbuat kalemi). Në këtë institucion, me të ardhur në Stamboll ka punuar edhe Samiu. Në faqen e parë të kësaj Gramatike, Naimi shkruan: «Gramatika është kyçi i çdo gjuhe dhe faktori kryesor i të mësuarit të gjuhës me lehtësi. Duke e ditur rëndësinë e gjuhës persiane e me qenë se nuk ekziston gramatikë simbas metodës së re, unë marr inisiativën që ta përpiloj. Më 20 Muharem 1288 (= 11.IV.1871) Mehmed Naim». Kjo është një gramatikë e shkurtër, por praktike, hartuar simbas gramatikave evropiane me paragrafe (ka gjithsej 125 paragrafe).

3. — Naimi, megjithëse poet, është interesuar, sadopak, edhe për çështje të gjuhës shqipe e të gjuhësisë, në përgjithësi. Ky interesim, me sa dimë ne, fillon aty nga viti 1886, d.m.th. pesëmbëdhjetë vjet mbas botimit të «Gramatikës së persishtes». Sikurse edhe rilindasit e tjerë, ai ishte për origjinën e shqipes nga pellazgjishtja. «Gjuha shqipe e sotme — shkruan në «Istori e Shqipërisë» — është Pellazgjishtja, q'është' e bij'e

10) Naim Frashëri, *Bagëti e bujqësija*. Redaktuar dhe pajisur me shënime nga Shaban Demiraj, Ndërmarrja shtetërore e botimeve. Tiranë, 1956. F. 32.

11) Naim Frashëri, *Lulet' e verësë*. Redaktuar dhe pajisur me shënime nga Shaban Demiraj. Ndërmarrja shtetërore e botimeve, Tiranë, 1956. F. 68.

12) Dh. S. Shuteriqi, *Naim Frashëri*, «Literatura jonë», II, 6-7, 59-63, Tiranë, gusht-shtator 1948. — Dh. S. Shuteriqi, *Histori e letërsisë shqipe*, për shkollat e mesme, botimi i parë, Tiranë, 1955; botimi i dytë, Tiranë, 1958. fq. 169-170. — USHT, *Historia e letërsisë shqipe*, Tiranë, 1960, II, 41, 355-356. Dh. S. Shuteriqi, *Letërsia e re shqipe*, Tiranë, 1950, fq. 74-75.

13) Behar Shtylla, *Naim Frashëri*, «Literatura jonë», I, 3-4, 6, Tiranë, maj-qershor 1947.

14) Shefqet Musaraj, *Naim Frashëri*, «Letërsia jonë», IV, 10, 57, Tiranë, tetor 1950.

15) Nonda Bulka, *Frazeologjia shqipe (lokucionet) në veprën e Naim Frashërit*, «Historia e Skënderbeut», «Buletin i USHT, Seria shkencat shoqërore», 1(1957), 206-224.

16) Andrea Varfi, *Naim Frashëri*, «Letërsia jonë», IV, 9, 70-71, Tiranë, shtator 1950.

17) Zija Xholi, *Naim Frashëri*, Tiranë, 1962, fq. 64-66.

18) *Kavaid-i Farisiyye ber tarz-i nevin*. Eseri Mehmed Naim an hulefa-i Kalem-i Matbuat. Derssadet 1288. Mühendisyan Matbassı. 65 f. (13,5 x 20).

19) Hasan Kaleshi, *Veprat turqisht dhe persisht të Naim Frashërit*, «Gjurmime albanologjike», 1-2(1970)144, Prishtinë.

Sanskritesë, q'është gjuh' e Hindit e vjetërë, dhe mëm' e gjithë gjuhëra-
vet t'Evropësë. Po duke parë gjithë gjuhët' e shkruara të moçime, që
janë ndruarë, nuk mundimë të themi se Shqipëtarët' e moçim flisnin
gjuhën tënë si është sot së gjithash»²⁰. Me sa duket, Naimi nuk i ka pasë
të qarta tezat e Bopp-it dhe të Meyer-it. Ndoshta ai nuk e ka ditë që
familja gjuhësore indoeuropiane nuk e përfshin në gji të vet pellazgjish-
ten. Unë mendoj se poetin tonë, në këtë mes, e ka rrëmbyer renomeja e
madhe e Hahn-it dhe vepra e tij monumentale. Siç dihet, konsulli i Austri-
së, në librin tij «Albanesische Studien» ngre problemin pellazgjik, duke
mbledhur lajmet e Grekëve të vjetër e duke konkluduar se Ilirët, Epirotët
e Maqedonasit e vjetër janë Pellazgë; po kështu edhe Shqiptarët e sotëm,
duke quajtur Pellazg popullin më të vjetër të Greqisë dhe të Shqipërisë.
Ai nuk e shtroi çështjen nëse Pellazgët janë popull indoeuropian apo pa-
raindoeuropean (1854) dhe nuk shtroi as problemin e gjuhës, sepse gju-
hësia krahasimtare indoeuropiane sapo themelohej.²¹ Duke folur për ori-
gjinën e Shqiptarëve dhe të gjuhës shqipe, Naimi shkruan: «Shqipëtarëtë
janë bijt' e Pellazgëve». ²² «Pellazgëtë thuhetë se kan' ardhurë nga Hindi.
Në Hind ish një komp i vjetërë, i cili fliste gjuhën Sanskrite. Ajy komp
me gjithë gjuhët të tij, ka humburë lashtazi. Të diturit' e Evropës nga
ç'ka lënë ky komp mbloodh' e vunë mb'udhë gjuhën' e humburë! Këjo
gjuhë ngjan shumë me gjuhëtë Shqip». ²³ Në lidhje me vendin e shqipes
në rreth të gjuhëve indoeuropiane, Naimi, me sa duket, ka qenë i ndi-
kuar nga idetë e August Schleicher-it, i cili, në drurin gjenealogjik të
tij, e pruri shqipen në afërsi të greqishtes e të latinishtes, po më afër
greqishtes. Të dy gjuhët klasike aso kohe besohej se ishin fort të afërta
me njëra-tjetrën dhe ky dijetar i përmbloodhi të dyja së bashku me emrin
«çifti i familjes pellazge». Rrugën e tij e ndoqën, më vonë, dy gjuhëtarë
të tjerë: G. Stier dhe Dh. Kamarda. Dihet se teoria e këtyre dijetarëve
është e gabuar. ²⁴ Ka të ngjarë që poeti ynë të jetë ndikuar, sadopak, nga
gjuhëtari i Horës së arbëreshëve të Italisë, veprën e të cilit rezulton ta
ketë njohur. ²⁵ Përsa i takon kësaj çështjeje, Naimi shprehet kështu:
«Gjuha Shqip ka të bënë me Sanskritenë, me gjuhën' e vjetërë t' Elinëvet
dhe me Llatinishtenë. Rrënjët' e fjalëve janë një, po mënyr'e Shqipesë
ngjan më shumë me Llatinishtenë dhe me të bijat' e saj, që rrojnë sot,
me Frëngjishten' e me Italishten' edhe me motrat' e tyre». ²⁶ Është inte-
resant të vërehet se, megjithëse pranon që shqipja hyn në një familje
të madhe gjuhësore me greqishten dhe me latinishten, Naimi anon më
shumë nga latinishtja. Këtu ka një ndryshim të dukshëm me Kamardën,
i cili ishte më tepër për greqishten. Përse, vallë, ngjet ky ndryshim? Nuk
dimë si ta shpiegojmë. Këtu mund të ketë arsye subjektive dhe objekte-
ve. Ndoshta rrjedh nga mosnjohja e problemit, nga mosthëllimi i tij.
Naimi në gjuhësi nuk është në fushën e vet. Përsa i takon lashtësisë së
shqipes, poeti ynë duket të ketë pasur parasysh edhe veprat filologjike të
De Radës, me të cilin, siç dihet, kishte lidhje përmes letërkëmbimit. Ja

20) Naim Frashëri, *Istori e Shqipërisë*, Sofje, 1899, fq. 4-5.

21) E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1959, fq. 17 (dispensë).

22) N. Frashëri, *Istori e Shqipërisë*, Sofje, 1899, fq. 3.

23) Poaty, fq. 33.

24) E. Çabej, vep. cit., fq. 6.

25) D. Camarda, *Saggio di grammatologia comparata sulla lingua albanese*, Livorno 1864.

26) N. Frashëri, *Istori e Shqipërisë*, Sofje, 1899, fq. 35.

ç' thotë poeti për këtë problem: «Gjuha Shqip i ka fjalëtë me pakë rrokje, pa kjo është një dritë për ata, që kanë diturin'e gjuhëvet, q'u rrëfen se gjuha Shqip është' e par' e gjuhëvet». ²⁷

Naim Frashëri është nga të parët dijetarë shqiptarë që ka dhënë mendime për disa çështje të gjuhësisë së përgjithëshme. Simbas tij. «... gjuhëtë ndahenë më katrë: Ariane, Semitike, Sllave dhe Mongole». ²⁸ «Llatinishtja dhe Greqishtja — thekson ai — kanë fjalë të gjata e me shumë rrokje, andaj mirenë vesh se janë të pasdajme. E tër' Evropa, gjer dije shkruante dhe këndonte Llatinishtenë. Në ditët tona u bënë gjuhët' e Evropësë, u vunë shkronja dhe vanë mbroth. Ashtu edhe gjuhët' e Sllavëret. Po shkronjat' e gjithë këtyre gjuhë s'janë bërë me shumë mendim, pa s'janë dhe aq të mira.» ²⁹ Duke vazhduar karakterizimet e tij për disa gjuhë të huaja, Naimi shprehet kështu: «Tyrqishtja është nj' ujëm i bashkuarë prej tri gjuhërash, ka arabishtenë, persishtenë dhe tyrqishtenë, që janë të huaja njera nga tjetra. Andaj do kohë të shumë, nge dhe mundim të madh sa të mësohetë. Ashtu dhe greqishteja ka të vjetrënë, që ka vdekurë me Omir' e me Pllatonë, ka ate, që flitetë, e cila është' e prishurë dh' e fëlliqurë, pa ka atë, që shkruhet' e këndohetë, e cila s' munt të ndahetë nga e vjetra, pa s'e mer vesh dhe njerëzija. Kështu dhe greqishtja s'është gjuhë për të mësuarë, se nuk' e di as i zoti, jo ta mësonj' i huaji». ³⁰ Sikurse shihet, autori shprehet kundër turqishtes, sllavishtes dhe greqishtes për t'u mësuar ndër mejtepet dhe skollirat. Jemi në vitin 1899, kur thohen këto. Ka 12 vjet që është hapur mësonjëtoreshja e parë shqipe në Korçë. Gjatë kësaj kohe shkollat shqipe janë shtuar, si në Jugë të Shqipërisë ashtu edhe në Veri. Lëvizja kombëtare është rritur shumë. Populli nuk kërkon më autonomi, por pavarësi të plotë. Sapo ka qarkulluar manifesti i Rilindjes: «Shqipëria ç'ka qënë, ç'është dhe ç'do të bëhetë» e Samiut, ku është paraqitur platforma e shtetit të ri të ardhshëm shqiptar. Prandaj Naimi gjen rast të mirë të shprehet, edhe një herë, plot optimizëm dhe entuziazëm për gjuhën amtare: «Gjuha shqip është m'e par' e gjithë gjuhëvet t'Evropësë dhe m'e bukurë, po është' e pa punuarë». ³¹ «Gjuha Shqip e vjetrë, e re, e folurë, e shkruarë, është një e vetëme, është shumë' e lehtë për Shqipëtarëtë. Gjuh' e mëmëdheut është' e nevojshime shumë për kombinë, se pa atë s'bënetë gjë fare. Si për gjithë punëtë, ashtu dhe për besëtë është mjaft gjuh' e vet, se dhe Perëndisë njeriu duhet t'i falet e t'i lutetë me zemrët të tij, me zët të tij, e me gjuhët të tij. Mirë shumë' është gjithë kombi të këndonj' e të shkruanjë gjuhën' e mëmëdheut, se vetëm me atë munt të qytetërohetë si duhetë. P'ajy, që do më tej, munt të mësonjë Frëngjishtenë, q'është gjuh'e përgjithëshme». ³² Poeti ynë diti t'i lidhë mirë çështjet gjuhësore shqipe me politikën kombëtare të kohës. Ai diti të dallojë atë që është esenciale, thelbësore. U shpreh kundër përdorimit të turqishtes dhe të greqishtes. pse që të dyja ishin të rrezikshme ndër ato ditë, po u prononcua për frëngjishten, pse ishte e nevojëshme për kulturën e shqiptarëve, si gjuhë e huaj, dhe pse nuk paraqiste rrezikshmëri nga ana politike. Lavdëroi shqipen, theksoi lashtësinë e saj, vuri në dukje cilësitë e saj të larta. po

27) Poaty, fq. 35.

28) Poaty, fq. 35.

29) Poaty, fq. 36.

30) Poaty, fq. 37.

31) Poaty, fq. 31.

32) Poaty, fq. 37.

nënvizoi edhe fatin e keq të gjuhës sonë amtare që është e papunuar. Ai vetë dha shembullin e një punëtori të madh, të një lavruesi të shquar.

Naimi ka shprehur mendime edhe për alfabetin e vjetër të gjuhës shqipe. Për këtë çështje, ai është mbështetur tek vepra e Hahn-it. Këtë albanolog, poeti ynë e citon në faqen 6 të veprës së tij «Istori e Shqipërisë», botuar për të parën herë, në Sofje, më 1899, me gjallje të autorit. Shënimi i tij është vënë si referencë, në fund të faqes, kur shpreh mendimin që «Shqipëtarët' e vjetërë i muarë shkronjatë nga Finikasitë»: Hahn, *Albanesische Studien*. Ky referim na dëshmon, nga njera anë, që Naimi ka njohur gjermanishten. Ky është një tregues me rëndësi për kulturën albanologjike të poetit. Nga ana tjetër, tregon se Naimi ka pasë interesa shkencore për studimet albanologjike. Duke krahasuar veprën e Hahn-it «Shënime përmbi shkrimin e vjetër pellazgjik», shqipëruar e botuar më 1910,³³ me të dhënat e poetit, në na rezulton se Naimi i ka pasur si mbështetje kryesore «Studimet shqiptare» të Hahn-it në përpilimin e librit të vet «Istori e Shqipërisë», veçanërisht aty ku flet mbi vjetërsinë e alfabetit shqip. Meqenëse Hahn-i, në këtë kapitull, përmend Franz Bopp-in, Grimm-in, Giuseppe Crispi-n, Malte-Brun-in, Xylander-in, Müller-in, etj., për rrjedhim, Naimi u njoh me veprat dhe me mendimet e këtyre dijetarëve, që u morën drejtpërdrejt apo tërthorazi, në një mënyrë apo në një tjetër, edhe me shqipen. Se sa ndikim ka ushtruar Hahn-i mbi Naimin, mjafton të riprodhojmë vetëm disa fraza të konsullit austriak për t'u bindë për një gjë të tillë; prandaj kritika e sotme shkencore ndaj pikëpamjeve gjuhësore të Naim Frashërit mendoj se duhet të jetë e matur dhe e urtë. Hahn-i ka gëzuar një autoritet të madh, në gjysmën e dytë të shekullit XIX, në rrethet shkencore; nga ana tjetër, teza e tij pellazgjike shkonte edhe me politikën kombëtare të Rilindasvet, sepse sostenonte lashtësinë e popullit shqiptar sidhe autoktoninë e kombit tonë. A mund të dilte Naimi mbi reputacionin shkencor të një Dr. Hahn-i? A e kishte poeti ynë atë kulturë gjuhësore solide sa të revidonte ose të kritikonte tezat e këtij albanologu? Unë mendoj se jo. Kështu, thom, duhen gjykuar mendimet e Rilindasit tonë të shquar lidhur me lashtësinë e alfabetit shqip. «Është për të habiturë, — thotë Naimi — duke qënë Shqipëtarëtë më të parë n'Evropë, e atërit'e gjith' Evropaset, qysh nukë kanë shkruarë gjuhën' e tyre! Sindëkur i muarë Elinetë shkronjatë nga të huajtë, si i muarë Llatinëtë nga Grekëritë, e shkruanë gjuhën' e tyre, muntinë dhe Shqipëtarëtë, t'i merninë nga Grekërit, a nga Llatinëtë. Qysh rojti një komp mijëra vjet pa shkronja në mest të fqinjëve me shkronja? Janë dhe shumë nga të dituritë që kanë thënë, se Shqipëtarët' e vjetërë kishinë shkronja të gjuhës së tyre, e pasdaj kanë humburë».³⁴ «Përse të mos besohet — shkruan Hahn-i — që ai Shqiptari, që ka mbrojtur kaq mi vjet zakonet e etërvet, të mos shkruaj sot akoma si ata? Neve na duket shumë më e çudiçme, që një komb, — të diturit e të cilit marrin gjithmonë diturinë e të huajve — ruan endë në jetën e përditëshme, si në martesë, në lindje, në vdekje, zakonet e Romës së vjetër e të Greqisë, sikundër i kanë sot Shqiptarët, e fort lehtë pas kësaj, të kenë ruajtur në mes të ca fiseve, brez pas brezi, një shkrim të vjetër.»³⁵ «Nuk

33) Dr. Hahn, Abeceja Shqip. *Albanesische Studien I.*, *Shënime përmbi shkrimin e vjetër pellazgjik*, përkëthyerë prej Eqrem B. Vlora, Stamboll 1910. Imprimerie F. Loeffler, Place du Tunnel, Péra. F. 57+7 të panum.

34) N. Frashëri, *Istori e Shqipërisë*, vep. cit., 5.

35) Hahn, vep. cit., 36.

mund të besohet — vazhdon Hahn-i — që të jetë ruajtur një abecé afër 3.000 vjet midis Shqiptarëve, të ketë qenë përdorur nga 90 breza e më tepër, vetëm si trashëgim, pa ndërruar format e saj; kaq sa edhe me pamjen e parë na qëllon në sy shëmbëllim i saj me abecenë feniqishte». ³⁶ «Shumë të diturë — thekson Naimi — thonë se Shqipëtarët' i muarë qëmoti shkronjatë së pari nga Finikasitë, pa nga Shqipëtarët' e moçim i muar' Elinët' e vjetërë». ³⁷ «Pellazgët, — shkruan Hahn-i — që kanë qenë njerëzit e parë në Elladhë, përdornin një shkrim, që ua kishin prurë nga atdheu i tyre Fenikasit e ardhur. Më pastaj, erdhën në këto vende Elinët, u përzien e i shëmbëllyen Pellazgët vehtes së tyre, po pranuan, me shumë gjëra të tjera, edhe shkrimin e të mundurvet.» ³⁸ «... kjo abecé — vazhdon Hahn-i — është bij' e feniqishtes dhe motër e greqishtes së vjetër. E ata duhet andaj prap të besojnë, që një herë, si në Greqi edhe në Shqipëri, ka qenë shkruarë gjuha me një lloj germash; po, më pastaj, në Greqi, dituria duke përparuar, ndërroi, lehtësoi format e shkrimit deri sa u bë shkrimi i sotëm i Grekëve; në Shqipëri, pas pak kohë jete, duket sikur nuk u përdor më, mase humbi përpara shkronjavet të lehtësuara të Grekëve, ngriu pa ndërruar parafytyrimin e tij» ³⁹. Duke përfunduar çështjen e vjetërsisë së alfabetit shqip, Naimi shkruan: «Janë gjëndurë gurë germadhash në Shqipëri të mbeturë nga koh' e vjetërë, të cilët janë shkruarë me gjuhë shqip dhe me shkronja shqip. Këto shkronja ushëmbëllyjnë më shumë shkronjavet të Finikasvet, se shkronjavet' e vjetëra t'Elinëvevet. Andaj, thonë se Shqipëtarët' e vjetërë i muarë shkronjatë nga Finikasitë, Grekërit' e moçim i muarë nga Shqiptarëtë. Po shkronjat' e vjetëra të Shqipesë vetëm nër gurtë, që thamë më sipër i shohëmë, nukë gjetkë. Andaj ja shtijëmë që s'janë përdorurë shumë». ⁴⁰ Edhe ky mendim i Naimit është nxjerrë nga Hahn-i, i cili shkruan pikërisht këto: «... abecëja shqip është drejt për drejt përfytyrimi i abecesë së Finikasvet... Neve padyshim jemi të sigurtë që kjo abecé është trashëgim nga më i vjetri qytetërim i Shqipërisë. Përmbi këtë çështje kemi folur edhe në të përkohëshmen: Sitzungsberichte der philosophisch-historischen, Klasse der Kaiserl. Akademie der Wissenschaften, dhjetor 1850. Pas kësaj më dërgoi zotri profesor Franz Bopp-i nga Berlioni, përpara vdekjes së tij, një shëmbëllim të abecesë shqip me atë të Finikasvet; këtë e kemi përdorur në paragrafin 7. Kjo është njëra nga provat me rëndësi për vjetërsinë e kësaj abecëje». ⁴¹

Ç'është ky alfabet, për të cilin bën fjalë Naimi dhe Hahn-i? Në të vërtetë, këtu është fjala për alfabetin e Teodor Haxhifilipit apo të Dhaskal Todhrit (1730-1806), alfabet prej 53 shkronjsh, padyshim më i ploti i alfabeteve të vjetër. Hahn-i e pandehte shumë të vjetër këtë alfabet, aqë sa nuk vonoi ta quajë «pellazgjik». Po më 1901, një vit mbas vdekjes së Naimit, Gjergj Pekmezi u dërgua nga Akademia e Vjenës në Elbasan për studime dialektologjike dhe me një porosi të veçantë për studimin e shkrimit të vjetër të këtij qyteti. Mbas hetimeve të tij dhe të profesorëve të tij, rezultoi se alfabeti nuk është aqë i lashtë sa pandehej, po i çpikur vonë prej një njeriu me dituri të thellë. Kështu, Gj. Pekmezi, duke rrë-

36) Poaty, 31.

37) N. Frashëri, *Istori e Shqipërisë*, vep. cit., 6.

38) Hahn, vep. cit., 36.

39) Poaty, 33.

40) N. Frashëri, *Istori e Shqipërisë*, vep. cit., 6.

41) Hahn, vep. cit., 12.

zuar të tëra teoritë e përparëshme, përfundon duke thënë se, «alfabeti i vjetër i Elbasanit është alfabeti greqisht kursiv i shekullit XVIII, i stilizuar individualisht». ⁴² Mahir Domi shënon se «në të vihet re ndikimi i alfabetit glakolikt sllav, ka disa shkronja greke e ndodh që ka të bëjë edhe me alfabetin latin». ⁴³ Geitler-i pat shprehë mendimin se alfabeti që përdori Todhri është babai i alfabetit glagolitik. ⁴⁴ «Padyshim, — thekson Dh. S. Shuteriqi — kjo tezë është e gabuar: alfabeti glagolitik është m'i vjetër se ai i Todhrit. Po ballafaqimet që bën Geitler-i në mes të dy alfabeteve janë shumë interesante dhe tregojnë afëri evidente në mes tyre.» ⁴⁵

Naim Frashëri është interesuar edhe për interpretimin e prejardhjes së disa fjalëve, d.m.th. për një farë etimologjie — do të thoshja. «Gegësë — shkruan ai — Elinët' e moçim i thoshinë gjigë (gjigas), edhe kjo fjalë doj-me-thënë burr'i fortë. Fjala Ilir' është prapë shqip: do-me-thënë ilirë, vënt' i lir' e i pa penguarë; fjala Albani është nga fjala shqip Arbëni; Maqedhonia është Madhë-dhëni, që do-me-thënë vënt'i gjërë». ⁴⁶ Më poshtë, ai thotë se «Fjala Pellag munt të jetë Pellgas, se erdhë nga Pellgu i detit, a munt të jetë plak a pleq, po të huajtë e kanë ndryshuar» ⁴⁷. Po më atë vepër, Naimi shënon se «fjala Mollosi ngjan që të jetë Malësi», ⁴⁸ «Mollosoj» (Malësori) ⁴⁹. «Maqedhonija kishte shumë qytete; po më me emër' është Emathija (e madhja)... N'emërit t'Emathisë është quajturë Mat' i sotmë, q'është në Shqipëri» ⁵⁰. S'ka dyshim, se këto interpretime janë të pabazë, janë etimologji fantastike, që nisen nga disa koinçidenca të rastit ose nga ana e jashtme e fjalës ose nga ana formale. Ato nuk mbështeten në ligjet e fonetikës historike. Nga ana tjetër, disa nga këto etimologji u patën interpretuar, më përpara nga arbëreshët; kështu, p.sh., Giuseppe Crispi fjalën pellag e spiegon me shqipen plak ⁵¹; po kështu edhe De Rada ⁵².

4. — Naimi u interesua edhe për ndryshimet dialektare të gjuhës shqipe, sidomos në fushën e fonetikës, në vokalizëm dhe në konsonantizëm. Në veprën e tij «Istori e Shqipërisë», në kapitullin VIII, nën titullin: «Ndryshimet' e gjuhësë», poeti shkroi edhe për disa veçori kryesore të gegërishtes dhe të toskërishtes, veçanërisht për fenomenet fonetike të rotacizmit, asimilimit, palatalizimit, itacizmit dhe citacizmit. «Gjithë gjuhët' e tjera — thekson ai — kanë shumë ndryshime, po dhe Shqipja ka pakë. Toskërija fund' e fjalës' e thotë me *r*, si në llatinishtet, në frëngjishtet e në italishtet; Gegërija e thotë me *n*, si në greqishtet e në per-

42) Shkrimtarët Shqiptarë, I, 113, Tiranë, 1941. — G. Pekmezi, *Vorläufiger Bericht ueber das Studium des Dialektes von Elbasan*, «Anzeiger der philosophisch-historischen Cl. der k. Ak. der Wissensch.», Vienë, 1901.

43) USHT, *Historia e letërsisë shqipe*, I, 322, Tiranë, 1959.

44) L. Geitler, *Die albanesischen und slavischen Schriften*, Vienë, 1883.

45) Dh. S. Shuteriqi, *Anonimi i Elbasanit*. Shkrimi shqip n'Elbasan në shekujt XVIII-XIX dhe Dhaskal Todhri, «Buletin i Institutit të Shkencavet», III, 1, 38, Tiranë 1949.

46) N. Frashëri, *Istori e Shqipërisë*, vep. cit., 7.

47) Poaty, 33.

48) Poaty, 12.

49) Poaty, 11.

50) Poaty, 17.

51) Giuseppe Crispi, *Memoria sulla lingua albanese*, Palermo, 1831.

52) G. De Rada, *Antichità della nazione albanese e sua affinità con gli Elleni e i Latini*, Napoli, 1864.

sishtet: *ardhurë* = *ardhunë*; *trimëri* = *trimëni*; *dashuri* = *dashuni*. Toskërija përdor *mb*, Gegëria *m*, si: *mbanj* = *maj*, *mbush* = *mush*, etj. Shkronjën e, Gegëria e ka *â*, të trash' e me hundë, si: *hënë* = *hân(ë)*; *dhën* = *dhân*, etj. Si ca vende të Toskërisë, që s'thonë dot *sy*, *dy*, *ky*, po thonë: *si*, *di*, *ki*, ashtu dhe ca vende në Gegëri tek është *q*, vënë *ç*, tek është *gj*, vënë *xh*, si: *qint*, *çint*; *gjashtë*, *xhashtë* etj.»⁵³ Po në disa vise ai nxjerr edhe konkluzione të gabuara. Ja ç'shkruan ai për disa ndryshime dialektore: «Janë dhe ca fjalë, që thuhën të lathitura më ca vende, si: *dreq* = *drejt*; *frë*, *frëri* = *frên*, *freni*; *gju*, *gjuri*, = *gjû*, *gjuni*; *pajqonj* = *paqësonj*; *mëjtohem* = *mendohem*; *verë* = *venë*; *katër* = *katrë* a *katërë*; *vjeç* = *vjetsh*, etj. Fjalëtë: *Leskovik*, *Pllaneshnik*, etj. pandehenë të huaja, po janë fare Shqip, si: *thallanik*, *mesnik*, *gjalpanik*, etj. Ashtu edhe *Borockë*, *Ogorckë*, *Vrënjckë*, etj. janë si dhe: *Nemërckë*, *skërckë*, etj. janë Shqip».⁵⁴

Poeti ka prekur edhe çështje të ortografisë së shqipes. Ai ka ditur të kapë një nga problemet më nevrologjike të drejtshkrimit të gjuhës sonë, siç është *e-ja*. «Shkronja *ë* — thekson shkrimtari ynë — në fjalët me dy rrokje këndohetë mirë, si: *dhashë*, *dasmë*, *lëmë*. Ashtu dhe në fjalët me tri rrokje, si: *fytyrë*, *mënyrë*, *pasqyrë*, etj. Po në të tjera, si: *ardhurë*, *shënuarë*, *dëshiruarë*, *ishinë*, *kishinë*, *pininë* etj. fort pakë zihetë ngoje, me gjith' atë shkruhetë, se ashtu duhetë. Vetëm në vjershët kur duhet të këndonetë shkruhetë, kur s'duhetë shuhetë, se prish fare masën' e vjershësë, si: *Ishin njerës të mirë*, / *Pa nuk' ishin të pështirë*, etj.»⁵⁵

Përsa i takon drejtshkrimin, gjuha e Naimit, siç qe e natyrshme për kohën, paraqet luhajtje. Këto kanë të bëjnë shpesh me liritë poetike, që merr poeti, veçanërisht me përdorimin ose jo të zanores *ë*.⁵⁶ A. Xhuvani thekson se duke marrë parasysh evolucionin e deritashëm të gjuhës, bie në sy përnjëherë te proza e Naimit përdorimi i shpeshtë i zanores *ë*, që është karakteristikë e veçantë e toskërishtes e që e dallon në kaq prej gegërishtes. Këtë shkronjë e përdor rregullisht Naimi edhe në ato trajta fjalësh, që nuk përdoren më në toskërishten e re, në qoftë se mund të themi se proza e Naimit bashkë me atë të Vretos, të Mitkos e të tjerëve shkrimtarë toskë të Rilindjes formon toskërishten e vjetër, kurse ajo mbas kësaj periudhe formon toskërishten e re.⁵⁷ Në këtë paragraf do të paraqesim, në mënyrë të përmbledhur, inkoherenat dhe fluktuacionet e ortografisë së Naimit. Shpeshherë ai përdor dy mënyra të shkruarit për të njëjtën kategori gramatikore:

a) Emrat e gjinisë femërore, që mbarojnë me *-i* të theksuar, në trajtën e shquar i shkruan herë me *-a*, herë me *-ja*: *Asija* (IP, 51), *Persija* (IP, 54), *Elvetija* (IP, 54), *Siqelija* (IP, 57), *Austrija* (IP, 62), *Rusija* (IP, 63), por: *Norvegjia* (IP, 57), *Sveqia* (IP, 57) dhe *Sveqa* (IP, 57), *Rusia* (IP, 60), *Austria* (IP, 61), *Tyrqia* (IP, 67), *Italia* (IP, 68).

b) Emrat e njerëzvet që mbarojnë me *-o*, herë i shquan me *-ja*, herë me *-ua*: *Karllloja* (IP, 59), *Petroja* (IP, 61), *Pavllloja* (IP, 61), *Ferdinandoja* (IP, 62), por: *Lodovikua* (IP, 59) dhe *Llodhovikua* (IP, 60).

c) Në vend të emrave abstraktë foljorë femërorë, si *kthyerje* (D, 114), *nisje* (D, 58), përdor gjininë asnjënjësore: të *kthyerit* (D, 18), të *dalëtë* (M, 23), por edhe *dalje* (D, 18); të *thënët* (M, 21), por edhe *thënje* (M, 51).

53) N. Frashëri, *Istori e Shqipërisë*, vep. cit. 39.

54) N. Frashëri, *Istori e Shqipërisë*, 40.

55) Po aty, 40.

56) USHT, *Historia e letërsisë shqipe*, II, 356, Tiranë, 1960.

57) A. Xhuvani, art. cit.

c) Rasa gjindore e dhanore e shumësit të emravet e të mbiemravet paraqitet me dy trajta: me *-et* dhe me *-vet*: pun' e të vegjëlet (K, I, 3), u thosh *barinjet* (K, I, 13), epuni të *varfëret* (K, I, 18), gjuhërat e të *hua-jet* (K, II, 4); por: fëlliqjet e *ligësivët* (M, 3), të *mjerëvet*, *udhëtarëvet* (M, 43), *bijt' e Pellasgëvet* (K, II, 11).

d) Shumësin e emrit *pyll-i* poeti e përdor me tri trajta: *pyjtë*, *pyjet*, *pyllet*: Moisiu del nga *pyjtë* (HS, XIV, 138); *pylle* të gjelbëruar (BB, 4); *pyjet* e gjelbëruar (BB, 24).

dh) Për emrin *mik* ka *miq* në shumë; kurse për *armik* ka *armikë* (HS, I, 50).

e) Emrat mashkullorë, që në numrin shumë mbarojnë me *-e*, poeti herë i merr për gjini femrore, herë për mashkullorë: ndë vende të *nxehta* (D, 28), vende të *ngrohta* (D, 41), por: malet e *lartë* (BB), të *tjerë* qëllime (HS, I, 346), të *këqij* hidhërimë (HS, I, 348).

ë) Herë përdor trajtën e shkurtë të rasës kallëzore të njejësit të emravet: *gjaknë* (K, I, 10), *trupnë* (K, I, 13), herë përdor trajtën e plotë: *shpirtin* (K, I, 13), *Ahmetin* (K, II, 11). Lëkundjet shkojnë deri në dy-tri trajta: *atënë* e *atin*; *kalënë*, *kalnë*, *kalë*, *kalin*.

f) Mbiemrin: *i ndershëm* e shkruan me dy trajta: me *-ç* dhe me *-sh*: të *nderçim* (HS, I, 308); *i ndershim* (HS, I, 271).

g) Krahas trajtës më të përhapur të përemrit *ay*, Naimi përdor edhe *ajy* (BB, 14).

gj) Foljet, siç ka vënë re Xhuvani, i përdor në trajta të ndryshme: *mblerojnë* e *zbukurojnë* (K, I, 22), por edhe: *gjelbëronjënë*, *lulëzonjënë* (K, I, 22), *nxjerëmë* (D, 142) dhe *nxjerimë* (Gj, 73, 75); të *rrosh* (K, I, 5) dhe të *rronç* (K, I, 23); *ish* e *ishte* (K, I, 11); *kish* e *kishte* (K, I, 13); *thosh* e *thoshte*; *mbeçë* (K, I, 31), *mbeta* (K, II, 35); *marrë* dhe *marë* (HS, XX, 164).

h) Disa ndajfolje i shkruan me dy ose tri trajta: *lashtazi* (Gj, 33), që *lashtë* (D, 33); *përnjë-herë* (D, 8; K, II, 25); *për një herë* (K, I, 29, 49); *për-një-herë* (K, I, 33); *për një-herë* (K, I, 34); *kështu* (HS, II, 93); *kshtu* (HS, II, 94); *kshu* (HS).

i) Drejtshkrimi i disa parafjalëvet ka mjaft luhatie: *më*, *mi*, *mbi*: *më boshtit* (Gj, 6), *mi boshtit* (M, 4), *mbi boshtit* (M, 33), *mi cipët* (D, 7), *mbi cipët* (D, 7); *në*, *ndë*: *në dhet*, (M, 4, 45); *ndë dhet* (M, 43), *n'erët* (Gj, 67), *në erët* (K II 37), *nd'erët* (M, 4); *ndënë*, *nënë*: *ndënë gurt* (K, II, 9); *nënë dardhëtë* (M, 18).

j) Pjesëzën e mohimit *s'*, herë e shkruan *s'*, herë *z'*: *s'ka* (K, I, 36), *s'doj*, *z'donja* (K, I, 16, 35). Po kështu edhe pjesëzën *duke*: *duke ikur*, por edhe: *tuke ikur* (LV, 11).

k) Lidhëzën *tekdo* e përdor me dy trajta: Aleksandri *tek-do* vate, liroj njerëzinë, ndërtoj vendinë, bëri udhë, qytete etj. (ISh, 21); ... Shqipëtarëtë... *tekdo* venë, Shqipërinë *s'e* harrojnë. (ISh, 32)

5. — Naimi bëri një punë të shquar në fushën e gjuhës. Ai ndoq rrugën e çelur nga Veqilharxhi e Kristoforidhi, për një toskërishte të vetme letrare, të bazuar në gjuhën e gjallë të popullit, të spastruar mirë dhe të pasuruar me fjalë të reja nga brumi i saj. Gjatë gjithë jetës së tij, ai qe për një shqipe sa më të pastër, në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Kuptimplotë në këtë vështrim është qëndrimi i tij ndaj bejtexhinjve. Siç dihet, ai admironte këta për krijimet e tyre, por i dënonte rëndë për punën me gjuhën.⁵⁸ Lidhur me këtë çështje, Naimi shkruan: «Në mest

58) USHT, *Historia e letërsisë shqipe*, II, 355, Tiranë, 1960.

të vjershëtorëvet të Shqipërisë ka zënë kryenë Hasan i Zyk-Kamberit; pas ati janë: Nezimi, Hixhretiu, etj. etj. Po të gjithë kanë bërë faj, që s'faletë, e të metë që s'ndjehetë kurrë. Kanë përzjerë gjuhën' e bukurë shqip me fjalë të huaja! Gjuha jonë duhetë shkruarë fjeshtë shqip, se fjalët e huaja e shëmtojnë shumë. Është' e gjerë gjuha jonë dh'e bukurë shumë, ka fjalë fort të mira për të vënë në vënt të fjalëvet të huaja». ⁵⁹ Me njohjen e sigurtë intuitive, Naimi krijoi një sasi të madhe fjalësh të reja, veçanërisht të sferës intelektuale e shkencore. Shumica e tyre hynë në librat e tij të shkollave, po një pjesë e mirë hyri edhe në veprat e tij artistike. Naimi bëri, në të njëjtën kohë, punën kryesore për t'i futur në përdorim të përgjithshëm një shumicë neologjizmash të paraardhësve të tjerë, me vetë faktin që veprat e tij qenë më të përhapurat, më populloret. Neologjizmat që përdor Naimi, — thotë Dh. S. Shuteriqi — janë më shumë se pesëqind. ⁶⁰ Në krijimin e neologjizmave, me sa duket, Naimi u nis nga parimet gjuhësore të Leibnitz-it, emrin e të cilit e zë në gojë pikërisht aty ku bën fjalë për formimin e fjalëve në gjuhën shqipe. Ja si shprehet poeti ynë për këtë çështje: «Kish të drejtë i gjori Lajpniç që thosh: «m'epni shkronja të mira, t'u ap gjuhë të bukurë; m'epni gjuhë të bukurë, t'u ap qytetëri të mbaruarë». Gjuha Shqip si është vet' e bukurë, ashtu ka dhe shkronjatë të bukura, se janë bërë me mënt e me mëndim, nukë si u-gjetnë, p'andaj janë prerë si rroba pas trupit. Gjuha Shqip është pra shumë' e bukurë, po duhetë shkruarë me kujdesë dhe me shije e me bukuri. Të shkruhetë fjeshtë Shqip, e pa përzjerë me gjuhë tjetërë kurrë, se fjal' e huaj është si derri në dhën. Gjuha Shqip është mjaft e gjërë për ata, q'e dinë mirë, pa ka dhe lehtësinë, që bashkon dy fjalë, si *vetë-dije, mëmë-dhe, punë-mbarë, bukë-dhënës*, etj. etj.» ⁶¹ Ka mundësi që Naimi ta ketë njohur veprën e Leibnitz-it, shkruar rreth vitit 1697, ⁶² ose në origjinal ose në përkthimin frëngjisht të bërë nga Dutens-i, më 1768. Jokl-i vëren: «Në qoftë se krahasojmë metodën e Naimit, për pasurimin e gjuhës shqipe, me parimet e Leibnitz-it, kjo hipotezë i afrohet së vërtetës». ⁶³ Leibnitz-i parashtron në librin e vet disa rrugë për pasurimin e fjalorit të gjuhës. Parimet kryesore të tij, për krijimin e neologjizmave, mund të përmbliidhen në këto mjete: kërkimi dhe përhapja e fjalëve ekzistuese, që janë të mira, po që përdoren pak e që nuk janë fort të pëlqyeshme; ringjallja e fjalëve të vjetra, po që kanë mbetur në harresë, duke pasur parasysh gjuhën e popullit; pranimi i fjalëve të huaja deri sa meritojnë; formimi i fjalëve të reja, simbas rregullave të analogjisë, në një anë të përngjitura, dhe, në anë tjetër, të prejardhura. Jokl-i, Xhuvani, Cipo, Demiraj kanë provuar se Naimi, në krijimin e fjalëve të reja, është mbështetur në natyrën e gjuhës së gjallë të popullit shqiptar. Për të plotësuar nevojat leksikore në shkrimet e tij, Naimi ka ndjekur rrugët e zakonshme të pasurimit të gjuhëve. Siç dihet, këto rrugë janë: së pari, neologjizmat e krijuara nga vetë brumi i gjuhës me anë parashtesash, prapashtesash dhe kompozitash ose duke u mbështetur në modelet e gjuhëve të tjera («calque» gjuhësore); së dyti, duke u dhënë fjalëve të gjuhës amëtare një kuptim të ri; së treti, duke marrë huazime

59) *Iliadhë e Omirit*, këngë e parë, kthyerë prej Naim Frashërit, Korçë, f. 13.

60) USHT, *Historia e letërsisë shqipe*, II, 355, Tiranë, 1960.

61) N. Frashëri, *Istori e Shqipërisë*, 36.

62) Leibnitz, *Unvorgreifliche Gedanken betreffend die Ausübung und Verbesserung der deutschen Sprache*, 1697. E shënuam simbas Jokl-it, art. cit.

63) Jokl, loc. cit.

nga gjuhët e tjera (barbarizma).⁶⁴ Naimi krijoi fjalë të prejardhura me anë të dhjetë parashtesave: *ç-, çpër-, mos-, ne-, nënë-, pa-, parë-, përtej-; s-; shpër-*. Ai krijoi neologjizma me anë të tridhjetepesë prapashtesave: *-ar(e), -arak, -as, -atë, -azi, -çe, -esë, -(ë)ri, -ës, -(ë)si, -i, -im, -irë, -je, -m, -nik, -oj, -ole, -onjë, -ore, -osh(e), -ri, -si, -sirë, -shim, -shme, -tar, -të, -tor(e), -tuar, -ush, -th, -z, -za, -zi*. Me qenë se formimi i fjalëve te Naimi është bërë objekt trajtesash të ndryshme edhe më parë, sidomos nga Jokli, Xhuvani, Cipo, Demiraj, ne e pamë me vend që të mos e trajtojmë këtu. Kjo çështje meriton një shqyrtim të veçantë, duke ndjekur gjerësisht formimet që janë më karakteristike, më të përdorshme dhe duke thelluar vështrimin e sajimit të tyre. Me interes gjuhësor do të ishte ky problem: cilat nga këto fjalë të reja, të krijuara nga poeti, mbetën në përdorim dhe u futën në shkrimet tona të përditshme? Po kjo çështje do një studim krahasimtar të hollësishëm me paraardhësit e Naimit. Ai krijoi një varg neologjizmesh kompozitë të tipeve të ndryshme, këpujore dhe përcaktore, eksocentrike (bahuvrihi), etj. Ai e pasuroi leksikun e shqipes edhe me anë të përtëritjes së kuptimit të fjalëve, përdorimit të fjalëve të vjetra me vështrime të reja. Në këtë drejtim, ai lojti një rol të dukshëm. Në veprat e tij, shënon Dh. S. Shuteriqi, gjejmë rreth njëqind fjalë të tilla, të përshtatura veçanërisht për nevojat e terminologjisë së shkencave të natyrës dhe të shoqërisë. Kështu ai përdori fjalët: *bosht* (aksi i dheut), *degë* (segment-gjeometri), *fëmijë* (dinasti), *helli* (boshti i tokës), *hundë* (çip, kep - gjeografi), *kënt* (në gjeometri), *lëndë* (materie), *ngasërë* (ndarje shtetërore, qark), pesë *ngasëra* (pesë kontinente), *qark* (horizont)⁶⁵, *thërrime* (molekulë), *të holla* (minuta), *pasës* (satelit), *lëmsh i dheut* (glob), *përnjëshmës* (diametër), *gjymse* (hemisferë), etj. Ai krijoi neologjizma të posaçme për disa degë të dijes, si p.sh. *dhetregonjë* (gjeologji), *njeritregonjë* (antropologji), *tejshkronjë* (telegraf), *rrotullohës* (planet), *shronjë* (mjekësi), etj. Naimi ka meritën të ketë ringjallur mjaft fjalë të vjetra, pak a shumë të harruara, dhe të ketë futur në përdorim krahararizma të rralla. Disa herë, fjalëve që i gjeti ndër burime të ndryshme, u ndërroi pakëz trajtën.

Bukuria dhe pasuria e një gjuhe nuk qëndron vetëm në fjalët që e përbëjnë atë gjuhë. Fjalët janë një anë, lokucionet ose frazeologjizmat janë një anë tjetër, jo më pak të rëndësishme. Pa to, gjuha mbetet e thatë, e zbatë, anemike, pa kripë. Lokucionet janë ajka e një gjuhe. Në veprën e Naimit «Histori e Skënderbeut», Nonda Bulka ka qëmtuar afro treqind lokucione, të cilat poeti i ka përputhur me vend në mes të vargjevet. Të shkruash aq shkoqur, aq pastër, të përdorësh me mjeshtri veçantitë e asaj gjuhe, dhe t'i përputhësh po me aq mjeshtëri në gjuhë, të shkruash në mënyrë që të kuptojë edhe ai që s'di shkrim e këndim dhe të shijojë edhe ai më i ngrituri në kulturë, kjo don të thotë se i ke hyrë thellë gjuhës në tërë drejtimet e saj.⁶⁶

6. — Gjuhëtarët tanë A. Xhuvani, K. Cipo dhe Sh. Demiraj kanë vënë re, se në veprat e Naimit, si në poezi ashtu edhe në prozë, ka, aty-këtu, disa elemente të dialektit të veriut ose ndonjë shkodranizëm. Këto gëzizma mund të jenë përfshirë me qellim të paracaktuar nga autori, qoftë për arësye gjuhësore, për një farë njësimi në gjuhë, qoftë për arësye stilistike, për atë që quhet «kolorit lokal». Ndoshta «këto janë gjurma

64) E. Çabej, *Albanologji*, Tiranë, 1949 (dispensë).

65) USHT, *Historia e letërsisë shqipe*, II, 41, Tiranë, 1960.

66) N. Bulka, art. cit.

të vjetra të toskërishtes ose të asaj epoke, kur dy dialektet, gegërishtja dhe toskërishtja, ishin më afër njera me tjetrën, sikurse duket ky fenomen në gjuhën që përdorin të vjetrit, Buzuku, Budi o Bogdani. Kjo mënyrë së shkruari gjindet edhe ndër shkrimtarë të tjerë të Rilindjes». ⁶⁷

a) Emra: *Hyji* = Zoti, perëndia (I. O., 7), *mëni-a* = mëri-a (I.O., 14), *mëndyrë* = mënyrë (BB, 323), *ner* = nder-i (BB, 223), *Shqypnisë* = Shqipërisë (BB, 223), *trimni* = trimëri (BB, 224), *venë* = verë (I. O., 67), *zotënisë* = zotërisë (H.S., 172);

b) Mbiemra: *e naltë* = e lartë (H.S., I, 8); kish një të *naltë* ndjenjë (H.S., V, 474): «Kemi një gegizëm, së cilës nuk i dihet arësyeja!» (K. Cipo); «t'i ap dritë Shqipërisë / nga shpirt' i ndritshim i tija» (H. S., I, 15-16): «Ortografia e këtij mbiemri është mjaft sa të na dëshmojë veprimin që kanë ushtruar mbi Naimin shkrimet plaka të Veriut» (K. Cipo).

c) Përemra: «Lule mbijn' tek pikon *tinë* » (L.V., VIII); «Na veth' e *tinë* = nga vehtja e tij (L.V., IX). Përemrin *tinë* e gjejmë në një këngë popullore shkodrane: «Mori *tinë*, moj vogëlinë».

ç) Folje: *bëzëj* (H.Sk., 101) nga folja gegërisht: *bëzâj* (bâj zâ); *t'i mashëronjë* = t'i gënjejë (H.S., X, 230); *rrejtur* (H.Sk., 202); *të shof* (BB, 220); foljen *qyr* e gjejmë ashtu siç përdoret në Shkodër = vërej, vështroj, shikoj; nga kjo ka krijuar kalkun gjuhësor *qyrimë* = teoremë. «Në det të math e të gjërë / Çdo valë, që të sheh syri, / Atje është deti tërë, / Po valëtë mirë *quri*» (L. V., XIX). «*Tue bâm...*» (BB, 224).

d) Ndajfolje: *njatë* = afër (BB, 356; H.Sk., 153, 180).

dh) Paskajorja: në veprat e Naimit të bie në sy përdorimi i paskajores perifrastike me pjesëzën parafjalore *me*. Me këtë formë të pashtjellur, Naimi ndërton fjali të pashtjellura shkakore, qëllimore, kushtore dhe lejore.

I) Fjali shkakore: «Hëna, *me qënë* shumë e vogël nga dheu, na duket e madhe». (Gj., 13) «Aleksandri *me mos lënë* mashkull, ndënj në front Eaqidhi i bir' i Arivesë». (I.Sh., 13) Po hëna, *me mos pasurë* ujëra e *me qënë* shumë m'e vogëlë nga dheu, duke plasurë cip' e saj shumë herë, iu mbarua zjarri.» (Rev. «Drita», II/23) «Unë të vrava, po *me mos dashurë*, vajçë të vrisnja dhelprënë e të godita ty». (K. II., 17) «S'është turp, *me qënë* dituritë, njeriu të jet' i paditurë e të rrij' i mahniturë?» (K. II, 29) Hëna nuk ka zjar brënda, se, *me qënë* e thatë, i ka plasurë radhazi gujata.» (K. II, 34)

II) Fjali qëllimore: «Hyji, për *me mos prishurë* dëfrimnë, u dha mollënë». (I. O., 7) «Për të mos përpjekurë njëri me tjetërinë e për *me mos mbetur* mb'udhë, vuri fuqinë heqëse». (M., 3) «Të munjam të fluturonja e të kishnjam krahë si ti, / me gas të math do t'i vinjam Shqipërisë brënda në gji / Për *me marë* drejt Shkumbinë edhe' Elbasan' e Tiranën / E *me arth* ke ti, o Shkodrë, të shof Drinin e Bujanën; /.../ Krojëne e Skënderbegut, q'i ka pas dhan ner Shqypnisë / Tue bam me trimni luftë e *m'e munt* mren' e Tyrqisë» (BB., 217-224).

shirë. (BB) «*Me qënë* ju gjallë në jetë, / Kurrë s'mundet Shqipërija.»

III) Fjali kushtore: «Zëmëra s'thuhetë zëmërë *me mos pasurë* mëshirë (BB. «*Me qënë* ju gjallë në jetë, / Kurrë s'mundet Shqipërija (H.S., 111) «*Me mos pasurë* ngajë, sa më shumë mërguarë të jetë nga fara gruaja, aqë më mirë është». (Flet. Bekt., 5). «Po nd'ato dy vjet të shkretë, / Sulltanit i vate mbarë, / se kush munt t'i hith' shigjetë, / *me pasur* mik Shqipëtarë». (H. S., XVII, 128-131).

67) A. Xhuvani, art. cit.

IV) Fjali lejore: «Hëna, *me qënë* kaq' e vogëlë, na duket sa dielli». (D., 118).

Përdorimi i formës së pashtjellur të paskajores perifrastike me pjesën parafjalore *me* në veprat e poetit është me rëndësi. Kjo çështje interesante dhe me vlerë për gjuhën shqipe mund të përbëjë objektin e një studimi të veçantë. Problemi në fjalë ka interes gjuhësor.

7. — Në fushën e sintaksës, ndër veprat e Naimit, kemi raste të thurjes së fjalëve që nuk janë në përputhje me mënyrën e zakonshme të lidhjes sintaktike. Këto raste formojnë ato që quhen *figura sintaktike*. Figurat sintaktike lindin sidomos për arsye të përshtatjes jo të zakonshme të gjymtyravet të fjalisë, por ato mund të lindin edhe për arsye të renditjes jo të zakonshme të fjalëve e të fjalivet, si edhe për ndonjë arsye tjetër sintaktike.⁶⁸ Si të tilla, te poeti ynë mund të gjinden: *anakoluta, atrakcioni, silepsi, hiperbati, zeugma, pleonazma*.

a) Anakoluta: «Nepër mest të gjithësisë / duke ikurë si lumë, / pa dritën' e Perëndisë, / drit' e madh' e shumë shumë / Bukurin' e Perëndisë, / që *ndrin soje gjithësija*, / Perëndin' e gjithësisë, / q'është vetë bukurija.» (H.S., XII, 17-24) «Aju m'i vogël' i tyre, / që vij nga gjithë m'i çquar, / pej fytyr' e pej mënyre, / Zoti e kish lartësuar, / të mirat gjith'i kish dhënë, / të ligat ja kish mërguar, / gjë të metë s'i kish lënë, / së gjithash e kish mbaruar.» (H.S., III, 49-56) «Dielli, që del nga qarku, / mos pandeh q'e pjellin retë». (H.S., III) «Udhëtar' e gjahëtorë q'u bie udha ndër male; / U ep mish, qumësht, kos, dhallë, ajkë, bukëvale» (BB). Anakoluta është figura që lind, kur në thurjen e ligjëratës pjesët që pasojnë nuk janë në vazhdimësi sintaktike me pjesët përpara, d.m.th. kur thurja e ligjëratës fillon me një mënyrë dhe mbaron me një tjetër, që është në kundërshtim me të parën.⁶⁹ Shqip mund të thirret *papasojë*.⁷⁰ Anakoluta, thotë Cipo, është një figurë sintaktike e shqipes së folur që reflektohet në literaturën popullore me efekte artistike të pamohuara.

b) Silepsa: «Pleqësija dhanë shortë / të bëhetë miqësija». (H. S., II). «Parësi e Shqipërisë, / ishte bërë zjar' e flakë, / s'i trëmbeshin Tyrqisë, / ndonëse ishin më pak.» (H.S., X, 77-80). «Tyrqitë ... le të na vinjë» (H. S., I, 295). «... parësija po dëfrenin» (H.S., IV, 525). «... e dinë bota e tërë» (H.S., VI, 85). «Venetija e kërkonte, / ubë armik me një herë». (H.S., IX, 30). Silepsa është figura e përshtatjes apo e ndërtimit simbas kuptimit (*constructio ad sensum*).

c) Atrakcioni: «Shtat' a tetë mij' u vranë, / e shih q'u prish ushtërinë, / më s'e nxij dheu Sulltanë». (H.S., X, 414). Në këtë rasë, kryefjala e fjalisë së varur është bërë kundrinë e fjalisë kryesore. Kjo dëgjohet edhe në gojën e popullit. K. Cipo shkruan: «Një nga karakteristikat e gojës së popullit dhe e folklorit tonë të shkruar është ky atrakcion i strukturës. Është një farë atrakcioni që ushtron fjalia krvesore mbi kryefjalën e fjalisë së varur duke ja hequr kësaj si kryefjalë dhe duke e bërë për vete kundrinë të drejtë. Me të tilla konstrukte janë mbushur përrallat, janë plot edhe veprat e Naimit.»⁷¹

ç) Hiperbati: «Tha: Zotërinj Shqipëtarë! / luftënë q'ubë, e patë?» (H.S., V, 493-494). Hiperbati në shqip mund të quhet *ndërrim vendi*. Në shkrimet poetike të Naimit e gjejmë nganjëherë mbiemrin të përdo-

68) S. Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, 1971, f. 442.

69) Po aty, fq. 443.

70) J. Rrota, *Syntaksa e gjuhës shqipe*, Shkodër, 1943, fq. 118.

71) K. Cipo, *Sintaksa*, Tiranë, 1952, fq. 117.

pur para emrit, që cilëson, por në shumicën e rasteve ai e bën këtë, i shtytur nga kërkesat e rimës ose të ritmit të vargut. P.sh. Në shumë të madhe punë / e qeshi mëndja Sulltanë / e gjeti si firaunë.» (H.S., 41-42). «Në zemër kish mirësitë / e ndë mëndje diturinë / në shpirt kish të madhe dritë.» (H.S., 49) «Shumë të math turp më pruri, / tha, e humptë Perëndija, / e me të keq e përzuri.» (H.S., 122).

d) Zeugma: «... po Shqipërinë mos e lini, / mirësit' e Shqipërisë / i mbani mos i harroni, / nga vetijat' e Asisë / ndruhi mos i afëroni.» (H.S., 350-351). Zeugma ndodh atëhere, kur një folje, e cila në vete nuk i përshtatet veç një fjale, shtje në rreth edhe fjalë të tjera. Shqip mund të quhet *përfshimje* ose *lidhni*.

dh) Pleonazma: «një herë që moti» (H.S., III, 168).

Në sintaksën e veprave të Naimit, bie në sy përdorimi i plotësit etik apo i dhanores së lirë, veçanërisht në poezi: «Na erdhi n'Adrinopojë» (H.S., III, 196). «Të më donjë Shqipërinë» (H.S., IV, 490). «...erdhi e t'usgurdullua». (H.S., VII, 177). «Tregom'u dhe Shqipëtarët udhën e punës së mbarë, / Bashkom'i, bëm'i vëllezër edhe fjeshtë Shqiptarë; / Falm'i, falm'i Shqipërisë ditën e bardh' të lirisë, / Udhën e vëllazërisë, vahn' e gjithë mirësisë». (B.B., 449-451).

Në veprat e Naimit, Sh. Demiraj ka konstatuar se haset shpesh përdorimi i përemrit lidhor që në rolin e kundrinës së zhdrejtë (në vend të përemrit lidhor të cilit), në rolin e plotësit të vendit (në vend të lidhëzës përemërore ku). P.sh. «Na erdhi n'Andrinopojë / një tatar i math ng' Asija, / që nuk i flitej me gojë.» (H.S., 42). «Dh'ajy q'imbarohej jeta, / në mest të shokëvet binte.» (H.S., 114). «Nga të gjitha mbretëritë / së Krujës i dha Zoti / më shumë fuqi e dritë, / q'ishte mbret Gjon Kastrioti.» (H.S., 6).

Një aspekt me rëndësi të Naimi janë edhe sinonimet: «Sulltan Murat' ish mahnitur, / me shumë lodhje' e me ftigë». (H.S., XI, 266). «... dhe me gjak lyer e ngjyer». (H.S., V, 7). «Zin' e gjëmënë po shpinte». (H.S., I, 98). «... epi jet' e dit' e dritë!» (H.S., XX, 372). «Gjithë bota po e dinte, / q'ajo Shqipëri e ndjerë / kurtin' edhe robërinë / s'e ka hequr as një herë.» (H.S., XXII, 269-272).

Sintaksa poetike e Naimit është me vlerë të veçantë. Ajo nuk është bërë objekt studimi deri më sot. Ne këtu nuk do të merremi me shqyrtimin e saj, mbasi del jashtë caqeve të këtij punimi. Megjithatë po shënojmë, në kalim, se veprat e poetit tonë të shquar kanë mjaft elemente të sintaksës poetike, si epitete, përsëritje fjalësh (dyzim ose konduplikacion, anaforë, epanastrofe, epinalepsis), antitezë, pasthirmë (esklamacion), pyetje retorike (interogacion), apostrofë, personifikim, heshtje (reticencë), shkallëzim (gradacion), koniunkcion (lidhje), disiunkcion, intonacion poetik, theks emocional, etj.

8. — Bazat e gjuhës sonë letrare të sotme u hodhën që në gjysmën e dytë të shek. XIX, në një kohë kur populli ynë nuk kishte shtetin e vet kombëtar, por ishte ngritur më këmbë për t'u çliruar nga zgjedha e huaj, për të fituar pavarësinë e për të krijuar një shtet kombëtar, ku gjuha shqipe të shkruhej e të lavrohej lirisht⁷² Mbi rolin e poetit për zhvillimin e gjuhës letrare, në disa artikuj dhe studime, të botuar mbas çlirimit, ka pasë edhe pohime të tilla: «Naimi formoi një gjuhë letrare...»⁷³.

72) A. Kostallari, *Mbi disa veçori strukturore e funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë*, «Studime filologjike», 2(1970)12.

73) DH. S. Shuteriqi, *Naimi Frashëri*, «Literatura jonë», II, 6-7, 63, Tiranë, gusht-shtator 1948.

«Naimi ... hodhi bazat e një gjuhe letrare në Shqipëri»⁷⁴. «Te Naimi ... kemi ... formonjës in ... e gjuhës sonë letrare»⁷⁵. «Naimi krijoi i pari gjuhën tonë letrare...»⁷⁶. «Naimi është themelonjësi i gjuhës sonë letrare»⁷⁷. «Naimi ishte dhe mbetet ... themelonjësi i gjuhës letrare shqip...»⁷⁸. «... këtë gjuhë themeloi Naimi».⁹ «Naimi formoi gjuhën shqipe».⁸⁰ Unë mendoj se këto pohime nuk janë të drejta. Shkencës i ka hije objektiviteti. Detyra jonë si punonjës të gjuhësisë së re shqiptare është që të vemë në dukje rolin pozitiv të poetit për zhvillimin e mëtejshëm të gjuhës letrare, të evidencojmë kontributin e tij të vyer për zhvillimin e gjuhës letrare shqipe. Me të drejtë shënon Eqrem Çabej: «Po të themi se Naimi krijoi gjuhën kombëtare letrare, mohojmë gjithë traditën e gjuhës sonë para Naimit. Naimi është vazhdues i traditës në gjuhë, ai që e çoi atë mjaft përpara si gjuhë letrare».⁸¹ Lidhur me këtë problem, Shaban Demiraj shkruan: «... të formuarit e kësaj toskërishteje letrare të përbashkët gjatë shekullit të XIX nuk duhet marrë në mënyrë të prerë si përfundimi i punës së vetëm këtij apo atij shkrimtari. Ajo do parë më tepër si fruti i punës së një vargu shkrimtarësh, që me veprat e tyre ndihmuan në të formuarit dhe në të përhapurit e saj. Natyrisht në mes të këtij vargu shkrimtarësh kryet e vendit e zenë dy vëllezërit frashëriotë, Samiu dhe Naimi, në gjuhën e të cilëve përfaqësohen jo vetëm përpjekjet e tyre të mëdha gjuhësore por edhe ato të shkrimtarëve të tjerë toskë apo që shkruan toskërisht si Kristoforidhi. Nga ana tjetër, do mbajtur parasysh se procesin e formimit të një toskërishteje letrare të përbashkët e lehtësoi së tepërmi edhe vetë zhvillimi i të folmeve të toskërishtes, të cilat paraqiten shumë më afër njëra jatrës se sa të folmet e gegërishtes ndërmjet tyre.»⁸² Prej kohësh, Dh. S. Shuteriqi ka vënë në dukje se gjuha e Naimit është pranë gjuhës së gjallë të popullit. Poeti pati disa avantazhe: ishte nga një krahinë, ku toskërishtja paraqitet në format më të përgjithshme të saj, dhe jo në forma tepër të dalluara dialektale, si, fjala vjen, labërishtja dhe çamërishtja. Naimi ishte nga Dangëllia, ku flitet një toskërishte e mesme. Nga ana tjetër, Naimi kishte jetuar me vjet në Janinë, Sarandë dhe Berat. Ai njihte, pra, nëndialektet kryesore të toskërishtes. Prandaj edhe gjuha e tij është një toskërishte mjaft e natyrrshme. Naimi njuh mirë, jo vetëm sintaksën e toskërishtes, po njuh mirë edhe vlerën e fjalëve dhe të shprehjeve, di t'i verë mirë në dukje dhe në përdorim, ua njuh fuqinë evokuese dhe stilistike. Duhet shënuar, gjithashtu, se Naimi është artist, e ka të zhvilluar sensin e gjuhës përmes sensit artistik. Fraza e tij rrjedh vetiu. Gjuha e tij është pranë nesh. Ai i qëndroi besnik gjuhës popullore. Naimi e ka respektuar parimin e një ortografie fonetike, të pranuar nga botuesit e «Alfabetares» së Stambollit (1879).⁸³ Naimi bëri përpjekje të madhe për ta bërë shqipen

74) Dh. S. Shuteriqi, *Letërsia e re shqipe*, Tiranë, 1950, fq. 75.

75) A. Varfi, *Naim Frashëri*, «Letërsia jonë», IV, 9, 71, Tiranë, shtator 1950.

76) Poaty.

77) Sh. Musaraj, *Naim Frashëri*, «Letërsia jonë», IV, 10, 57, Tiranë, tetor 1950.

78) Poaty.

79) Poaty.

80) Poaty.

81) «Buletin për shkencat shoqërore» 2(1954)131.

82) Sh. Demiraj, *Disa shënime rreth lëvrimin të gjuhës shqipe gjatë shekullit të XIX*, «Buletin i USHT, Seria shkencat shoqërore», 1(1959)72.

83) Dh. S. Shuteriqi, *Naim Frashëri «Literatura jonë»*, II, 6-7: 63, Tiranë gusht-shtator 1948.

një gjuhë kulture. Vepra e tij që një mbështetje e mirë për zhvillimin e mëtejshëm të gjuhës sonë. Ai i shkroi veprat e tij në një kohë kur gjuha jonë fillon të bëhet një gjuhë kulture, kur popullit i duhen dhënë elementet e para të shkencës. Naimi dhe rilindasit e tjerë ndjenë nevojën për terminologjinë shkencore, për fjalë të ndryshme diturake. Naimi vetë, për shtjellimin e botëkuptimit të tij, për moralin dhe idetë e tij atdhetare e ndjeu nevojën edhe më shumë se rilindasit e tjerë për fjalën abstrakte. Një pjesë e madhe e neologjizma të tij mbetën në përdorim. Ka edhe që nuk dëgjohen më. Metoda që ai përdori me aqë sukses në formimin e tyre, do të mbetet si një shembull pune të pastër dhe të frytshme gjuhësore në shqip⁸⁴. Naimi, si shumë bashkëkohës të tij të kulturës, eci në gjurmët e më të mirëve, e zhvilloi dhe e shpuri shqipen më tej; gjuhën letrare e pasuroi me fjalë të tjera nga gjuha e gjallë dhe më e shëndoshë e popullit, me fjalë shqipe të harruara, që mund të përdreshin fare mirë, me fjalë të reja që krijoi simbas rregullave të analogjisë. Me një lavrim të tillë, të thellë dhe të kujdesshëm, Naimi kontribuoi në zhvillimin e mëtejshëm të shqipes letrare. Suksesi që pati ai në këtë drejtim, përhapja në masë e gjuhës së tij dhe përdorimi i saj nga një varg njerëzish, që filluan të shkruajnë simbas tij, tregoi se Naimi njihte mirë gjuhën shqipe.⁸⁵ Për të gjykuar drejt rolin e Naimit për zhvillimin e gjuhës sonë, duhet të mendojmë rrethanat në të cilat krijoi dhe botoi ai. Shqipja në atë kohë nuk ka qenë shumë e punuar. Nuk mohohet puna e madhe, që bënë shkrimtarët dhe lavruesit e shqipes para poetit. Po Naimi gjuhën tonë e zhvilloi, e pastroi, e limoi, e përpunoi, e pasuroi dhe e çoi edhe më lart. Gjuha e tij është e thjeshtë, popullore dhe e pastër. Gjuha popullore e Naimit, në thjeshtësinë e vet, ka qenë e është kurdoherë aq e lehtë dhe e aq e kuptueshme. Dëshira kryesore e poetit ka qenë të mbesë i popullit, duke mos ju larguar asnjëherë gjuhës së tij. Në këtë drejtim u bë mësues i popullit. Për Naimin gjuha është, jo vetëm mjeti për të fituar dije, por edhe elementi kryesor që përbën kombin. Me anë të gjuhës, Naimi luajti një rol të madh për bashkimin e popullit shqiptar në luftën për çlirim nga zgjedha pesëshekullore turke. Naimi shpalli me zë të fuqishëm, se kombi shqiptar do të ngrihet, se ai nuk mund të shuhet, sepse ka gjuhën e vet të ëmbël dhe të fuqishme: «... Shkronjat e gjuhës dhe ajo e diturisë drita, / Do ndrisin kombin me shkëlqim të çelë pors dita, / Do sjellin një vëllazëri, të gjitha mirësitë, / Një shekull t' artë, një liri dhe tërë lumturitë».⁸⁶ «Është një fakt me rëndësi të madhe — shkruan Behar Shtylla — që Rilindja kombëtare e Shqipërisë karakterizohet me çlirimin e Atdheut nga zgjedha e huaj, po edhe me përtëritjen dhe hovin e gjuhës e të kulturës së popullit tonë. Gjuha është një faktor i madh për unitetin nacional të një populli. Gjer në kohën e Naimit, shqipja kishte mbetur prapa, e papunuar, gjuhë pothua e pashkruar, sepse veprat e rralla dhe të vjetra të Buzukut, të Frangut të Bardhë dhe të Bogdanit as që diheshin se ekzistonin nga populli shqiptar. Naimi pati meritën e madhe të shkruajë vepra me gjuhën e popullit, gjuhë e thjeshtë dhe e kuptueshme. Këtë ai e pastroi, e punoi dhe e ngriti në dinjitetin e gjuhës letrare. Ai kishte një dashuri të madhe, një kulturë të vërtetë për gjuhën shqipe: «E ku shkruhenë në kartë / Fjalët' e gjuhësë së zjarhtë.» / Këto dy vargje dëshmojnë se sa

84) Poaty.

85) Sh. Musaraj, art. cit.

86) Zija Xholi, *Naim Frashëri*, Tiranë, 1962, fq. 64.

e çmonte gjuhën Naimi. / «Gjuha jonë sa e mirë! / Sa e ëmbël! sa e gjërë! / Sa e lehtë! sa e lirë! / Sa e bukur! sa e vlerë!» / Dhe me shqipen e barinjve, të fshatarëve e të luftëtarëve, ai shkruan vepra të bukura. Gjuha e Naimit bëhet gjuha e gjithë shqiptarëve që shkruajnë, qofshin toskë, qofshin gegë, aqë e madhe qe influenza e tij dhe aqë e pastër gjuha e tij. Gjuha e Naimit është gjuha e Rilindjes, gjuha e vjershave që ngrejnë dhe bashkojnë popullin në luftë dhe i hapin prespektivat e një jete të re, të lirë e të përparuar. Edhe në këtë çështje, Naimi na vlen si mësim. Vepra e tij është një monument për gjuhën shqipe dhe pasuri e madhe për literaturën tonë. Të gjitha këto dëshmojnë vlerën e Naimit, influencën e tij në atë kohë... Naimi me veprën e tij del si drita e parë që hedh rreze mbi t'ardhmen e re të Shqipërisë, dritë e fortë dhe shpresdhënëse.»⁸⁷

R é s u m é

LA CONTRIBUTION DE NAIM FRASHËRI A LA LANGUE ALBANAISE

Durant ce dernier cinquantenaire, la langue de Naim Frashëri est devenue l'objet d'analyse et d'étude détaillée par les spécialistes N. Jokl, A. Xhuvani, K. Cipo, Sh. Demiraj, Dh. S. Shuteriqi, et d'autres. Ses productions ont été examinées sous plusieurs aspects: phonétique morphologie syntaxe, sémasiologie et lexicologie. Ont connu un traitement circonstancié aussi les mots formés par le poète (néologismes et calques), les élargissements de sens au moyen de préfixes et de suffixes, le traitement et la formation de mots composés, etc.

Naim Frashëri a été un véritable polyglotte. Il connaissait les langues classiques, les langues du Levant et plusieurs grandes langues de l'Occident. Cette ample préparation lui a été d'un concours efficace à s'occuper aussi des questions de la langue. Déjà en 1871, il a fait éditer une *Grammaire du persan d'après la nouvelle méthode*.

Quoique foncièrement poète, Naim Frashëri s'est intéressé également à la question de la langue albanaise. Comme tous les autres artisans de la Renaissance, il considérait l'origine de la langue albanaise provenant du pélasgien. Il est un des premiers savants albanais qui ait donné des opinions sur des questions de la linguistique générale. Il s'est prononcé aussi sur l'ancien alphabet de l'albanais.

Naim Frashëri s'est intéressé aussi pour l'interprétation de l'origine de plusieurs mots albanais, c'est-à-dire à connaître certaines étymologies, mais sans succès. Il a écrit également sur plusieurs différences dialectales de la langue albanaise, surtout dans le domaine de la phonétique, et a abordé aussi des questions de l'orthographe albanaise.

Pour ce qui est de l'orthographe, la langue de Naim Frashëri, comme c'était naturel pour son temps du reste, présente des oscillations. Naim Frashëri a fait un travail d'envergure dans le domaine de la langue. De toute sa vie il a été pour un albanais le plus riche que possible, dans le plein sens du mot.

Naim Frashëri a formé des mots dérivés au moyen de dix préfixes et de trente-cinq suffixes. Dans ces productions on observe, parfois également, quelques éléments du dialecte du Nord, des guéguismes ou même quelque shkodranisme (expressions typiques du parler littéraire de Shkodër).

Dans le domaine de la syntaxe, sont à mentionner des figures syntaxiques. La syntaxe poétique de Naim Frashëri a une valeur toute spéciale. Le poète a eu une part importante au développement ultérieur de la langue littéraire albanaise. Pour Naim, la langue a été un grand facteur pour l'unité nationale du peuple albanais.

87) Behar Shtylla, *Naim Frashëri*, «Literatura jonë», I, 3-4, 6, Tiranë, maj-gershor 1947.